

## DEKLARATË PËR SHTYP

### Shqipëria ndërmerr nismën 'Observatori i Femicidit'

**8 mars 2024** - Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me UN Women, ndërmori nismën 'Observatori i Femicidit'. E para në llojin e saj, kjo nismë do të mbledhë dhe analizojë të dhëna, me qëllim përmirësimin e politikave dhe mekanizmave për parandalimin e vrasjes të grave dhe vajzave.

“Nëse nuk mbledhim të dhëna të sakta dhe të krahasueshme për një krim të caktuar, nuk do të jemi në gjendje ta kuptojmë atë plotësisht apo të dimë se si ta parandalojmë”, theksoi Erinda Ballanca, Avokatja e Popullit, në praninë e përfaqësuesve të qeverisë, shoqërisë civile, medias, akademisë dhe organizatave ndërkombëtare. Pjesëmarrësit e vendosën theksin tek nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike të vazhdueshme.

I përkufizuar si vrasje me dashje për shkak të gjinisë, femicidi mund të nxitet nga rolet gjinore të stereotipizuara, diskriminimi ndaj grave dhe vajzave, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit ndërmjet grave dhe burrave ose dhe nga normat shoqërore të dëmshme.

Gjatë 13 viteve të fundit, 159 gra dhe vajza janë vrarë nga burrat në Shqipëri, kryesisht nga anëtarë të familjes.

Në nivel botëror, sipas UN Women dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), rreth 89,000 gra dhe vajza janë vrarë qëllimisht gjatë vitit 2022 në mbarë botën. Rreth 48,800 gra dhe vajza u vranë nga partnerët e tyre ose anëtarë të tjerë të familjes. Kjo do të thotë se mesatarisht çdo ditë, më shumë se 133 gra dhe vajza janë vrarë nga të afërmit e tyre.

“Femicidi përfaqëson një dështim madhor të shoqërisë. Duhet ta ndalojmë! Krijimi i ‘Observatorit të Femicidit’ është një kontribut praktik për të siguruar se masat mbrojtëse ekzistuese dhe përpjekjet parandaluese do të jenë plotësisht të efektshme”, u shpreh Michele Ribotta, Përfaqësues i UN Women në Shqipëri.

'Observatori i Femicidit' do të bashkëpunojë me aktorët e përfshirë, që luajnë rol në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave rreth femicidit në Shqipëri. Të dhënat do të mblidhen dhe analizohen në përputhje me Kuadrin Statistikor të miratuar nga Kombet e Bashkuara. Kjo nismë është ndërmarrë në bashkëpunim me UN Women, si pjesë e Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

Reporterit Special i Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave u ka bërë thirrje shteteve palë që të ngrenë mekanizma për mundësimin e të dhënave vjetore dhe analizave rreth rasteve të femicidit. Ngritja e Observatorit të Femicidit është pjesë e përgjigjes së Shqipërisë ndaj kësaj thirrjeje.